



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2018:032815

Datë: 20.06.2019

Numri i dokumentit: 00369709

P.nr.107/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, Fepartamenti i përgjithshëm penal, gjyqtari Sulltan Dobraj e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurit Y. D. i akuzuar sipas PTH-ës nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.1348/2017 te dt.06. 07.2017**, për veprën penale vetëgjyqësi nga neni 418 par.1. të KPRK-ës, mbajtjes së shqyrtimit fillestar me **dt.30,04,2018** ne praninë e prokurorit te shtetit Ersan Qavolli dhe të pandehurit, ne te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndersa me dt. 24.05.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Y. D.**, i lindur me dt., i biri i A. dhe nënës S., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ESHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt.31,05,2017 rreth orës 15:00, ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend se ti drejtohet organit kompetent, në dëme të dëmtuarit H.B., në atë mënyrë që i pandehuri gjersa kishte të hapur kontestin në lidhje me një parcelë prej 11 ari me të dëmtuarin, i cili ishte duke ndërtuar shtëpi në tokën e ti për të cilën ka leje ndërtimi të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, mirëpo i pandehuri pa e pritur vendimin e gjykatës shkon në vendin e ngjarjes dhe i ndërpret ndërtimin shtëpisë të dëmtuarit.

- **Me çka ka kryer vepër penale vetëgjyqësi nga neni 418 par.1. të KPRK-ës.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 85, 86 nenit 418 par.1 të KPK, nenit 498, 499 te KPPK-ës, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me këtë vërejtje gjyqësore të pandehurit i bëhet me dije se e ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbenë vepër penale dhe nëse kryen prapë një vepër të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion me të rëndë penal.

I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore nga Peja me Aktakuzën **PP/II.nr.1348/2017 te dt.06.07.2017**, ka akuzuar te pandehurin Y. D. për veprën penale vetëgjyqësi nga neni 418 par.1 të KPRK-ës, ka propozuar të caktohet seanca e shqyrtimit gjyqësore të administrohen të gjitha provat e duhura e më në fund i pandehuri të shpallet fajtorë dhe të dënohet në bazë të ligjit si dhe të detyrohet në pagesën e shpenzimeve procedurale-penale.

Gjykata ka marre aktgjykim P.nr.149/2017 te dt. 08.05.2018 me te cilin e ka pranuar kërkesën e prokurorit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, ku te pandehurit i ka shqiptuar një ndenim me gjobe dhe i ka dhënë mundësin te pandehurit te ushtroj kundërshtimin ne afat prej 8 ditësh.

I pandehuri në afat ligjor ka ushtruar kundërshtim kundër aktgjykimit P.nr.149/2017 të dt.08.05.2018.

Me dt.30,04,2019 është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi gjyqësor në të cilin shqyrtim i pandehuri e ka pranuar fajësinë.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar dhe ka konsideruar se me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit e duke u bazuar edhe nen provat tjera te cilat ndodhin ne shkresat e lendes ne tërësi është vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i vihet ne barrë, andaj gjykatës i ka propozuar që ta shpallë fajtor ta dënoi ne baze te ligjit, ndërsa pranimi i fajësisë.

I dëmtuari H.B. në fjalën përfundimtare deklaroi se pajtona me pranimin e fajësisë që bëri i pandehuri dhe nuk parashtroj kërkesë pasurore juridike.

I pandehuri ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: shprehi keqardhje, jam shumë i penduar, kundërshtimin e kam bërë se jam i pa punë gjendjes së dobët ekonomike por premtoj që nuk do ta përsërisë më këto veprime dhe kërkesat e mia do të ja drejtoj gjykatës dhe krejt çka kamë do të kërkoj zgjidhje nga gjykata tani e tutje.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: me dt.31,05,2017 rreth orës 15:00, ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend se ti drejtohet organit kompetent, në dëme të dëmtuarit H.B., në atë mënyrë që i pandehuri gjersa kishte të hapur kontestin në lidhje me një parcelë prej 11 ari me të dëmtuarin, i cili ishte duke ndërtuar shtëpi në tokën e ti për të cilën ka leje ndërtimi të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, mirëpo i pandehuri pa e pritur vendimin e gjykatës shkon në vendin e ngjarjes dhe i ndërpret ndërtimin shtëpisë të dëmtuarit.

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do te shpallet fajtor për veprën penale te lartcekur, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do të këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, i cili pranim fajësie mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në kuptim të nenit 257 të KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se e pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë konform nenit 248 të KPP-ës, ndërsa pranimit i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale

vetëgjyqësi nga neni 418 par.1 të KPRK-ës, ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës për këtë veprë penale, ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për këtë veprë penale, i ka shqiptuar vërejtjen gjyqësorë, e ka obliguar në kompensimin e dëmit dhe e ka liruar nga shpenzimet e procedurës penale.

Me rastin shqiptimit të vërejtjes gjyqësore gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ndaj të pandehurit. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjellja e mirë të pandehurit, premtimi i të se nuk do të kryej në të ardhmen vepra të tilla, i pa dënuar më parë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata ka vlerësuar se vërejtja e shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit të paraparë me nenin 41 dhe 85 të KPRK-së, si mase për rehabilitimin e të pandehurit por edhe si mase për parandalimin e të pandehurit dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Në bazë të nenit 453 të KPPK-ës, gjykata e ka liruar të pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale sepse ka konsideruar se i pandehuri është i gjendjes së dobët ekonomike dhe do ta vështirëson edhe më tej gjendjen ekonomike të pandehurit nëse e ngarkon me shpenzime të procedurës penale.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,

P. nr.107/2018 të dt.24.05.2019

Sekretarja juridike

G J Y Q T A R I

Sabiha Hoxha

Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e marrjes, drejtuar gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.